



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC /ORAHOVAC

---

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)  
Nr./Br./No 01/110 Nr. i faq./Br.str./No.pg 84  
Data/Datum/Data 25/02/2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja s) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe dhe nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësit dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.19 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.02.2026, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e komisionit *ad hoc* për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkurruar për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe**

- 1. Caktohet komisioni *ad hoc* për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkurruar për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe.**
- 2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, ku 2 (dy) anëtarë do t'i zgjedhë Kuvendi i Komunës, ndërsa 3 (tre) anëtarë do të jenë nga fshati, si në vijim:**
  - 2.1. Florida Bajraktari,** anëtar i Kuvendit të Komunës-AAK;
  - 2.2. Flutura Thaqi,** anëtar i Kuvendit të Komunës - PDK;
  - 2.3. Nenad Stasiq,** anëtar i fshatit;
  - 2.4. Marko Spasiq,** anëtar i fshatit;
  - 2.5. Nemanja Qubanoviq,** anëtar i fshatit.
- 3. Detyrat e komisionit *ad hoc*, sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 11/2014, për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e këshillit për fshatin Hoçë e Madhe, janë:**
  - 3.1. Të verifikojë a është bërë aplikimi nga kandidatët brenda afatit kohor;**
  - 3.2. Të verifikojë a i plotësojnë kandidatët kriteret e seleksionimit;**
  - 3.3. Të informojë kandidatët për pranimin apo mospranimin e tyre sipas kriterëve;**
  - 3.4. Të dërgojë listën e përzgjedhur dhe të merituar të kandidatëve për aprovim në Kuvendin e Komunës.**
- 4. Komisioni *ad hoc* ka për obligim që në afate prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së kalimit të afatit për aplikim, të zgjedhë kandidatët që kanë konkurruar për anëtarë të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.**

5. Komisioni *ad hoc* do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat të përcaktuar ligjor.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe kryesuesi i Kuvendit.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Anëtarëve të komisionit ad hoc,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01Nr.110/26  
Datë:25.02.2026

  
**Fatmir Iska**  
  
**Kryesues i Kuvendit**